



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.588/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevc, kryesues, Rustem Thaçi dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Qerim Krasniqi me vendbanim në Zvicër, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 17 tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 02.09.2021, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET apeli Anr.588/2021 i paraqitur nga Qerim Krasniqi me vendbanim në Zvicër, me të cilin kërkon që të përfshihet në listën e votuesve jashtë Kosovës për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës që do të mbahen me datën 17 tetor 2021, për arsye se parashtruesit të apelit i mungon interesi juridik.

A r s y e t i m

Me datën 01.09.2021 PZAP-i ka pranuar një apel nga Qerim Krasniqi me vendbanim në Zvicër në të cilin pretendon se ai nuk gjendet në listën e votuesve jashtë Kosovës edhe pse se siç thekson i plotëson të gjitha kriteret për aplikim, ndërsa KQZ nuk e ka përfshirë në listën e votuesve jashtë Kosovës përkundër që ka pranuar ka pranuar konfirmimin se është në këtë listë.

Parashtruesi i apelit, apelit i ka bashkangjitur emailin nga KQZ për konfirmim të pranimit të aplikacionit, formularin e aplikimit si dhe dokumentin identifikuese/pasaportën për Qerim Krasniqi.

Me datë 01.09.2021 PZAP ka parashtruar kërkesë për përgjigje pranë KQZ, me të cilën ka kërkuar që të njoftohet lidhur apelin e parashtruar nga pala ankuese deri me datë 01.09.2021 në ora 18:00.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve brenda afatit kohor ka paraqitur përgjigje në kërkesë në të cilën ka theksuar se Qerim Krasniqi, me numër të regjistrimit të KQZ-së 2021171031197, është votues në listën e votuesve jashtë Kosovës. Emri i tij figuron në faqen numër 681 të Listës së Votuesve jashtë Kosovës, që është e publikuar në ueb faqen e KQZ-së.

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht apelin, gjeti se:

Parashtruesit te Apelit i mungon interesi juridik

Me datë: 01.09.2021 Qerim Krasniqi, ka parashtruar në PZAP ankese ndaj KQZ-se për mos përfshirje në listën e votuesve jashtë Kosovës për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të datës 17.10.2021.

PZAP ankesën e ankuesit e trajton si apel meqenëse ndaj vendimeve të KQZ palët e interesuar mund të parashtrojnë Apel.

Me rastin e shqyrtimit të Apelit PZAP iu ka drejtuar KQZ për të dhënë përgjigje në raport me apelin e parashtruesit dhe pretendimeve që dalin nga i njëjti.

KQZ me anë të përgjigjes në apel dërguar në PZAP ka konfirmuar se parashtruesi i apelit gjendet në listën e votuesve jashtë Kosovës dhe emri i tij figuron në faqen me numër 681, meqenëse i njëjti i plotëson kushtet për tu përfshirë në këtë listë.

PZAP duke vlerësuar apelin e personit në fjalë vlerëson se në rastin konkret të njëjtit i mungon interesi juridik për parashtrimin e apelit meqenëse i njëjti është i përfshirë në listën e votuesve.

Andaj PZAP-i, konstaton se apeli i parashtruar është pa interes juridik pasi Qerim Krasniqi, gjendet në listën votuese.

Prandaj PZAP-i, mbi këtë baze dhe nga arsyet e sipërsënuar dhe në kuptim të dispozitës së nenit 115.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 588/2021 më datën 02.09.2021

Kryesuesi i Panelit

Adnan Konushexhi

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa, sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.